


**AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL**

Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15, 39/16 dhe 164/2018 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 190/2019), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural publikon

**THIRRJE PUBLIKE nr. 08/2021**

për dorëzimin e kërkesave për pagesën e mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2021

**I. LËNDA E SHPALLJES**

Lëndë e kësaj shpallje është ndarja e përkrahjes financiare për masën në vijim:

Kodi i masës	Emri i masës	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme
121	Investime për modernizim të ekonomive bujqësore	
1	Ngritjen shumëvjeçare të vreshtave dhe pemishteve të reja, mbjelljeve shumëvjeçare me bimë aromatike dhe florës së mjaltit (faceli, evodi dhe bagrem) në sipërfaqe të reja	Deri më 2.500.000 denarë për shpenzime të pranueshme për shfrytëzues individual

**II. SHFRYTËZUESIT**

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë:

Subjektet
Ekonomi bujqësore e regjistruar në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore (RVEB) në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural

**III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE**

Mjetet dedikohen për ngritjen shumëvjeçare të vreshtave dhe pemishteve të reja, mbjelljeve shumëvjeçare të bimëve aromatike dhe florës së mjaltit (faceli, evodi dhe bagremit) në sipërfaqe të reja për periudhën prej 01 shtator 2020 deri më 31 mars 2021.

Për Masën 121 përkrahje financiare do të paguhet në parim të bashkëfinancimit të investimeve të përfunduara dhe të paguara nga ana e shfrytëzuesit në shumë prej 50% të vlerës së shpenzimeve të lejuara të pranueshme për investime.

Shkalla e bashkëfinancimit rritet në raste kur:

- Bëhet fjalë për investim të ekonomisë bujqësore bartës i së cilës është bujk i ri deri në 55%.
- Për investime në rajone me mundësi të kufizuara të prodhimit të bujqësore deri në 60%.
- Për investime në rajone me mundësi të kufizuara të prodhimit të bujqësore kur bartës i investimit është bujk i ri 65%.
- Për investime në bashkësi rurale ku nuk ka qasje 75%.

**IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET**

Kërkesat parashtrihen në mënyrë elektronike pas regjistrimit të realizuar në e-baranje.ipardpa.gov.mk Një kërkesë mund të parashtrijë vetëm një kërkesë për një masë ose më së shumti dy kërkesa të veçanta për masë të ndryshme duke marrë parasysh edhe masat e tjera nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2021.

Kushtet të cilat duhet të plotësojnë kërkesit e mjeteve janë përcaktuar me:

- Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2021 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 12/2021, 31/2021, 53/2021, 79/2021, 92/2021, 121/2021, 166/2021 dhe 175/2021)

- Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/2010, 53/2011, 126/2012, 15/2013, 69/2013, 106/2013, 177/2014, 25/2015, 73/2015, 83/2015, 154/2015 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/2017, 83/2018, 27/2019 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.152/2019, 244/2019 dhe 275/2019)

- Rregulloren për kushtet më të përafërta plotësuese për mbështetje të masave për zhvillim rural, shpenzime të pranueshme dhe shkalla e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për masë të veçantë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2011, 80/2013, 72/2014, 88/2015, 35/2016 dhe 101/2017).

- Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve për masë për zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2011, 80/2013, 35/2016, 101/2017 dhe 162/2018).

**VËREJTJE:** Prodhim, përgatitje për tregti, eksport-import, tregti me shumicë të materialit të farës dhe mbjelljes nga bimët bujqësore, tregti me pakicë dhe material të farës dhe mbjelljes të bimëve bujqësore mund të bëjnë subjektet e vendit dhe të huaj juridik dhe fizik – furnizues të cilët janë të regjistruar në regjistrin e furnizuesve të materialit të farës dhe në regjistrin e furnizuesve të materialit për mbjellje- Ligji për farë dhe material për mbjellje ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 39/06, 89/08, 171/10, 53/11, 69/13, 187/13, 43/14, 129/15, 39/16, 71/16, 83/2018 dhe 122/21).

Kërkesit e përkrahjes financiare duhet të krijojnë kërkesë elektronike për pagesë me të dhënat e kërkuara dhe në shtojcë të dorëzojnë dokumentet e domosdoshme elektronike (faturë ose fletëpagesë të cilat do të dëshmojnë shpenzimet e realizuara, fletëdërgesa të detajuara për fidanët/bagëtinë të verifikuar në mënyrë të rregullt, Vendim për regjistrim të ekonomisë bujqësore në RVEB pranë MBPEU jo më të vjetër se tre muaj nga dita e publikimit të thirrjes publike, llogari fiskale ose dëshmi pagimi PP30 me certifikatë pagimi ose dëshmi pagimi PP10 me certifikatë pagimi në emër të fituesit, formular për Kontratë e verifikuar në mënyrë të rregullt me nënshkrim dhe vulë dhe të tjera)

Kërkesit të cilët kanë plotësuar kushtet për shfrytëzim të mjeteve klasifikohen me pikë të përcaktuar në Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve të masave për zhvillim rural.

- Kërkesat me numër të njëjtë të pikëve do të klasifikohen sipas datës dhe kohës së parashtrimit të kërkesës elektronike në e-baranje.ipardpa.gov.mk

- Kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë elektronike në e-baranje.ipardpa.gov.mk nuk do të shqyrtohen.

Shfrytëzuesit e mjeteve duhet ti kenë të shlyera të gjitha obligimet financiare ndaj Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave si dhe obligimet financiare ndaj Ndërmarrjes publike për ekonomizim me kullota dhe obligim për ujë ndaj ndërmarrjeve për ujësjellës.

**V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE**

Udhëzimi për regjistrim të kërkesave në sistemin për parashtrim të Kërkesave në mënyrë elektronike për pagesë mund të merret në faqen kryesore të e-baranje.ipardpa.gov.mk Udhëzimi për shfrytëzuesit e masës së veçantë mund të merret pas fillimit të krijimit të kërkesës për masën.

**VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE**

Kërkesat e plotësuar në mënyrë elektronike për pagim nga Programi për përkrahje financiare për zhvillim rural për vitin 2021 në gjuhën maqedonase, të vërtetuar me nënshkrim dhe vulë nga kërkesi, së bashku me tërë dokumentacionin e duhur në origjinal dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" Kërkesë për pagesë dhe Numri i Arkivit i Kërkesës (0821-12125-XXXX/1). Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për humbjen apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

**VËREJTJE:**

Kërkesat të cilat nuk dorëzohen në mënyrë elektronike në e-baranje.ipardpa.gov.mk nuk do të shqyrtohen.

Afati përfundimtar i dorëzimit të kërkesave për pagesë është 30.09.2021.

Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh.

Formulari i kontratës, në 4 ekzemplarë (ORIGJINAL), në mënyrë të rregullt e verifikuar me nënshkrim dhe vulë të kërkesit, të dorëzohet me dokumentacionin e plotë deri te Agjencia!

Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: dhe në ueb faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk)

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural.

Sektori për miratim të pagesave.

Telefoni 02 3097 - 460, çdo ditë pune prej ora 10.00 deri në ora 14.00

E-mail: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)

**KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË DHE SHËRBIME TË UJIT I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Në bazë të nenit 10 paragrafi 3 të Rregullores për mënyrën dhe procedurën e përcaktimit të tarifës së shërbimeve të ujit dhe të tarifës së rregullt për shërbime të ujit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 63/17), Komisioni rregullator për energjetikë dhe shërbime të ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut e publikon këtë:

**NJOFTIM**

Njoftohen të gjithë subjektet juridike dhe fizike të interesuar që NPK KALE CENTAR ZHUPA, më 30.07.2021 deri te Komisioni rregullator për energjetikë dhe shërbime të ujit parashtrori Kërkesë për përcaktimin e tarifës për furnizim me ujë për pije për periudhën e rregullt 2022-2024 të vërtetuar në arkivin e Komisionit rregullator për energjetikë dhe shërbime të ujit nën numrin UP1 nr. 08-145/21 nga 30.07.2021.

Me Kërkesën e parashtruar, NPK KALE CENTAR ZHUPA kërkon që të ardhurat maksimale të rregulluara për secilin vit nga periudha e rregulluar dhe tarifat për çdo shërbim të ujit të jenë:

**1. Për furnizim me ujë të pijshëm**

Masa matëse	2022	2023	2024	
Të ardhurat maksimale të rregulluara	denarë	1.923.449	1.956.948	1.991.114
Sasia e ujit të porositur	m <sup>3</sup>	51.809	51.809	51.809
Tarifa mesatare	den/m <sup>3</sup>	37,03	37,68	38,33
Tarifa mesatare minimale	den/m <sup>3</sup>	36,93	37,58	38,23
Tarifa mesatare maksimale	den/m <sup>3</sup>	37,13	37,77	38,43

Subjektet juridike dhe fizike të interesuar, mendimet dhe propozimet në lidhje me Kërkesën e publikuar mund t'i parashtrorin më së voni deri më 3 shtator 2021, deri në ora 12:00 në Komisionin rregullator për energjetikë dhe shërbime të ujit përmes:

- E-mail: [erc@erc.org.mk](mailto:erc@erc.org.mk)
- Faks: 02/ 32 33 586
- Adresa: rr. Makedonija nr. 25, pallati Lazar Pop-Trajkov - kati 6-të, 1000 Shkup

Shkup, 30.08.2021

**KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGETIKË DHE SHËRBIME TË UJIT I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

ул. Македонија бр. 25, палата Лазар Поп-Трајков - 6<sup>та</sup> спрат • 1000 Скопје, Република Северна Македонија  
Централа 02 3233-580 • Факс: 02 2556 004 • [www.erc.org.mk](http://www.erc.org.mk) • e-mail: [erc@erc.org.mk](mailto:erc@erc.org.mk)


**Република Северна Македонија  
Министерство за животна средина и просторно планирање**

**Republika e Maqedonisë së Veriut  
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor**
**DREJTORIA PËR MJEDISIT JETËSOR**

**Informacion mbi njoftimin e parashtruar për qëllimin e zbatimit të Projektit: Ndërtimi i autostradës A4, nënndarja 2-ndërtimi i Autostradës nga kryqëzimi me rrugën lokale për fshatin Bllacë (njya Bllacë) për në Shkup (njya Stenkovec), km 2+000 deri në km 12+500**

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor informon publikun e interesuar se investitori Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në rrugën Dame Grujev 14, 1000 Shkup paraqiti një njoftim për qëllimin e realizimit të një projekti dhe për të përcaktuar nevojën për vlerësimin e ndikimit të projektit në mjedis: Ndërtimi i autostradës A4, nënndarja 2-ndërtimi i Autostradës nga kryqëzimi me rrugën lokale në fshatin Bllacë (njya Bllacë) në Shkup (kryqëzimi Stenkovec), km 2+000 deri në km 12+500. Projekti parashihet lidhjen me autostradë të Republikës së Maqedonisë së Veriut-së me Kosovën, përkatësisht Shkupin me KK-në Bllacë. Gjatësia e përgjithshme do të jetë 10.5 km.

Organi kompetent për marrjen e vendimit është Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Njoftimi i plotë për synimin e zbatimit të Projektit: Ndërtimi i autostradës A4, nënndarja 2-ndërtimi i Autostradës nga kryqëzimi me rrugën lokale për fshatin Bllacë (njya Bllacë) në Shkup (njya Stenkovec), km 2+000 deri në km 12+500 mund të shihen në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, me seli në Sheshin "Presveta Bogorodica" nr. 3, 1000 Shkup. [www.moep.gov.mk](http://www.moep.gov.mk)

**Personat për kontakt:**  
Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Jozhe Jovanovski - Udhëheqës i Njësisë për mbrojtje të mjedisit jetësor dhe aspektetve sociale  
tel: 078242319; E-mail: [j.jovanovski@roads.org.mk](mailto:j.jovanovski@roads.org.mk)  
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor  
Sheshi Presveta Bogorodica nr. 3, 1000 Shkup  
Aleksandar Petkovski - ndihmës udhëheqës i Sektorit për mjedisin jetësor  
tel: 076455460; E-mail: [a.petkovski@moep.gov.mk](mailto:a.petkovski@moep.gov.mk)

**Република Северна Македонија  
Министерство за животна средина и просторно планирање**

**Republika e Maqedonisë së Veriut  
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor**
**DREJTORIA PËR MJEDISIT JETËSOR**

**Informacion mbi njoftimin e parashtruar për qëllimin e realizimit të projektit: "Reparti për dekompozimin termik të plastikës dhe mbetjeve plastike"**

energji për përdorimin e llojeve të ndryshme të repartëve të energjisë ose motorëve me djegie të brendshme.

Organi kompetent për marrjen e vendimit është Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Njoftimi i plotë i synimit të realizimit të projektit: "Reparti për dekompozimin termik të plastikës dhe mbetjeve plastike" në komunën e Zhelinës, mund të shihet në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor - [www.moep.gov.mk](http://www.moep.gov.mk)

**Personi për kontakt:**  
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor  
infoeko@moep.gov.mk,  
përmes postës në adresën: sheshi Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup.

**Investitori**  
"DABALJU EKO" DOOEL  
Erhan Mahmut—Menaxher  
Rr. "Kozle" nr.8 Shkup  
tel. +389 23 131 131, e-mail: [info@w-eco.mk](mailto:info@w-eco.mk)  
"RVM RUBBER VAST MANAGEMENT" DOOEL  
Remiz Shabani—menaxher  
Rr. 101 bp.75 Porroj, Tetovë  
tel. +389 70 224 064, e-mail: [rvm\\_mk@yahoo.com](mailto:rvm_mk@yahoo.com)  
Filip Ivanov, ekspert i mjedisit jetësor  
tel. +389 76 361 677, e-mail: [ecoad@gmail.com](mailto:ecoad@gmail.com)

Qëllimi i krijimit të këtij reparti është përdorimi i sasive të mundshme të mbetjeve plastike në tregun vendas dhe ndërkombëtar për prodhimin e vajit piroolitik me vlerë dhe cilësi të përshatshme